



Raport I Komitetit per Komunitete për vitin 2015

Kacanik, Shkurt, 2016

Komiteti per komunitete si trup I perhershëm punues I kuvendit të komunës është formuar me vendim të kuvendit të komunës 01 Nr.16-2234/14 më datë 31.01.2014, në përbërje prej 5 anëtarësh ,e cila përbërje ka pësuar ndryshime në vazhdimësi.
Komiteti për komunitete deri më 31.07.2015 kishte këtë përbërje:

- 1.Z.Kadri Krivanjeva - Kryesues (AAK)
- 2.Znj.Nazife Krasniqi - Anëtare (LDK)
- 3.Znj.Vlora Dema - Anëtare (VV)
- 4.Znj.Elmihane Malsiu - Anëtare (Hendikos)
- 5.Z.Shemsedin Abazi - Anëtar (Shoqëria Civile)

		REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA		
		KOMUNA E KAÇANIKUT	OPŠTINA KAÇANIK	
I	Data	16.03.16	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	
	01		16-8903	Y.

Deri më 31.07.2015 z.Kadri Krivanjeva ka qenë kryesues I këtij komiteti.Në ndërkohë,kryesuesi I këtij komiteti ofron dorëheqje nga kjo pozitë për shkak të kalimit të tij në subjekt tjetër politik PDK dhe ulësja e tij mbetet diskutabile se a duhet mbajtur kjo ulëse nga po I njëjti kryesues apo I takon ndonjë subjekti tjetër politik.Për këtë çështje,kuvendi I komunës iu drejtua MAPL,me kërkesë për konsultim paraprak,por nuk pati konfirmim nga ky autoritet.Atëherë kuvendi I komunës me datë 31.07.2015 mori vendimet e nevojshme për plotësimin e Komitetit për Komunitete dhe në vend të anëtarit të dorëhequr z.Kadri Krivanjeva,caktoi znj. Pranvera Lokun,anëtare e këtij komiteti nga PDK.

Detyrat dhe përgjegjësitë e komitetit për komunitete

Në kuadër të kornizës ligjore,komiteti për komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e akteve normative të cilat janë kompetencë e kuvendit.Nga ky komitet kërkohet që të sigurohet se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen,të permbushen të gjitha të drejtat dhe interesat e të gjitha komuniteteve,të sigurohet se aktet normative që janë kompetencë e kuvendit mbrojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve,të iu ofrohen udhëzime organeve komunale mbi kornizën ligjore dhe insitucionale për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve,të përfshihen të gjitha komunitetet në vendimmarrje për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të lëshuara nga komiteti për komunitete.

Aktivitetet

Për shkak të mungesës së kryesuesit d.m.th. moskompletimit të këtij komiteti ,ka pasur ngecje në aktivitetet e këtij komiteti,duke pamundësuar realizimin e synimeve të tij.

Ky komitet ka shqyrtuar politikat komunale dhe praktikat për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Ky I fundit është munduar t'i rekomandojë kuvendit të komunës masat që duhet të mirren.

Aktiviteti I komitetit për komunitete gjatë vitit 2015 është karakterizuar dhe është kufizuar me vetëm një mbledhje për shkak të arsyes së lartpërmendur, edhe pse në mbledhjen e këtij komiteti ka pasur shumë çështje dhe kërkesa të komuniteteve të komunës për t'u shtjelluar. Në këtë seancë të rregullt të këtij komiteti kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e këtij komiteti që është mbajtur më 20.03.2015. Mund të themi se ka qenë seanca e parë dhe e fundit për vitin 2015. Kjo seancë është thirrur nga kryesuesi I komitetit, ndërsa nga shërbimi I kuvendit është mbajtur procesverbal. Kanë marrë pjesë nga ekzekutivi z. Enver Kamishi, z. Ramadan Luzha - drejtor ne QPS, z. Hajrush Dullovi-zyrtar për informim. Punimet e mbledhjes I monitoroi edhe z. Jeton Lika nga OSB-ja. Mbledhjen e kryesoi z. Kadri Krivanjeva-kryesues I këtij komiteti, ku në rend dite ishte:

1. Aprovimi I procesverbalit nga mbledhja e fundit 2014
2. Plani I punes ka qenë sa për njoftim
3. Kushtet e banimit të të pastrehëve në komunën e Kacanikut
4. Trajtimi I fëmijëve të mitur dhe dhuna në familje
5. Të ndryshme

Kemi vizituar disa familje të strehuara në objektin e Sanateriumit, duke nxjerrur kështu një propozim që familjes Terziu t'iu mirren fëmijët dhe t'iu jipen QPS nën përkujdesje sepse këta fëmijë jo vetëm që nuk kishin kushte, por s'kishin as edhe përkujdesje prindërore. As në shkollë nuk shkonin, mirëpo z. Ramadan Luzha nuk e arsyetoi marrjen e fëmijëve nga prindërit sepse iu duhej së pari t'iu mirret e drejta prindërore. Për t'iu marrur kjo e drejtë duhet që të dy prindërit të jenë të sëmurë psiko-fizikë, e babai ishte në gjendje të rregullt. Kështu e arsyetoi z. Ramadan Luzha, duke thënë se nuk ka ende licensim në strehimore pasi që nuk mund të blehen shërbimet pa pasur licensë.

Ato tetë familje duhet të kenë furnizim me ujë si kusht elementar dhe në fund si konstatim doli që kësaj familjeje t'i ndihmohet së paku me pako higjieno-sanitare. Nga QPS, ne u njoftuam se 800 familje në komunën tonë janë me asistencë sociale dhe 76 fëmijë me aftësi të kufizuara. Si përfundim I këtij raporti, duhet theksuar se është bërë edhe zgjedhja e kryesuesit të këtij komiteti, ku në vend të z. Kadri Krivanjeva (AAK) tash është znj. Nazife Krasniqi (LDK). Me këtë rast synojmë që ky komitet, veprimtarinë e vet në të ardhmen do ta orientojë në arritjen e synimeve dhe realizimin e planeve të këtij komiteti.

Komiteti për komunitete
Kryesuesja znj. Nazife Krasniqi

N. Krasniqi



Republika e Kosovës
Komuna e Kaçanikut



01/Nr _____ 2016

Data 14.03.2016

Nga : Komiteti për Komunitete

Për : Kuvendin e Komunës

Lënda : Plani i aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2016

Mars – 2016
Kaçanik

Plani i Aktiviteteve të Komitetit për Komunitet / Kaçanik 2016

Nr	Aktiviteti	Arsyja	Adresimi	përkrahja e nevojshme	Kalendari Kohor 2016
1	Vizitë shkollave të komunës së Kaçanikut	Dukurit negative të cilat po degradojnë arsimin	Drejtorja e Arsimit dhe Drejtoret e shkollave	Drejtorët e shkollave	Prill-Dhjetor
2	Vizitë qendrave të mjekësisë familjare	Monitorimi i ofrimit të shërbimeve, si dhe kushteve të punës në ofrimin e shërbimeve	Drejtorja e shëndetësisë	Drejtorja e QKMF-se dhe kryetaret e fshatrave	Prill-Dhjetor
3	Takim dhe bashkëpunim me OJQ-te të cilat veprojnë në komunën e Kaçanikut	Adresimi i përbashkët i nevojave dhe kërkesave të qytetarëve	Drejtoritë përkatëse	KK Kaçanik	Maj - Qershor
4	Takim me pensionistet	Problemet administrative me të cilët ballafaqohen pensionistet, me theks të veçantë ata nga jashtë	Drejtorja e shëndetësisë	KK Kaçanik	Prill -Dhjetor
5	Inicimi i hartimit të planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuar	ësjhtë përgjegjësi nga institucionet që PAK të kenë trajtim adekuat i cili i garantohet me ligj në bazë të drejtave të njeriut	Drejtorit Komunalë Kryetari i Komunës, Kuvendi Komunal	Ekzekutivi Komunal Kuvendi Komunal Drejtorit Komunalë Handikos	Prill- Dhjetor
6	Monitorimi lidhur me realizimin e të drejtave të qytetarëve.	Respektimi i të drejtave të njeriut	Institucionet lokale dhe qendrore	KK Kaçanik Drejtorit përkatëse Organet kompetente. OSCE	Prill –Dhjetor
7	Takime me bizneset dhe veprimtaritë artizanale	Problemet me të cilat ballafaqohen bizneset dhe mundësitë të cilat i ofron komuna për ti ndihmuar.	Drejtoritë përkatëse	Ekzekutivi Komunal Kuvendi Komunal Drejtorit Komunalë	Prill-Dhjetor

Vërejtje: Përveç këtyre aktiviteteve të cilat i kemi paraqitur në agjendë mund të ketë edhe kërkesa të tjera nga komuniteti.

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete : Nazife Krasniqi 